



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.77

29 maj

2009

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Vendim i KM nr.439, datë 22.4.2009	Për një ndryshim në vendimin nr.1694, datë 24.12.2008 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e numrit të punonjësve, për vitin 2009, në ministritë dhe institucionet qendrore”..... 3391
Vendim i KM nr.440, datë 27.4.2009	Për disa ndryshime në vendimin nr.194, datë 22.4.1999 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës së pagës së punonjësve mësimorë, në arsimin parauniversitar”, të ndryshuar 3392
Vendim i KM nr.441, datë 27.4.2009	Për një ndryshim në vendimin nr.561, datë 16.8.2006 të Këshillit të Ministrave “Për pagat sipas gradave për punonjësit, oficerë dhe nënoficerë, të Gardës së Republikës së Shqipërisë”... 3394
Vendim i KM nr.442, datë 27.4.2009	Për disa ndryshime në vendimin nr.901, datë 19.12.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/ nëpunësve, nëpunësve të kabineteve dhe punonjësve mbështetës, në administratën e disa institucioneve të pavarura”, të ndryshuar..... 3395
Vendim i KM nr.443, datë 27.4.2009	Për disa ndryshime në vendimin nr. 370, datë 14.6.2006 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve të administratës së prefektit”, të ndryshuar..... 3397
Vendim i KM nr.444, datë 27.4.2009	Për një ndryshim në vendimin nr.881, datë 20.12.2006 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kritereve për funksionet drejtuese dhe për strukturën e nivelet e pagave në Ministrinë e Punëve të Jashtme”, të ndryshuar..... 3399
Vendim i KM nr.445, datë 27.4.2009	Për disa ndryshime në vendimin nr.500, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të nivelit të pagave të punonjësve të Avokatit të Popullit”, të ndryshuar... 3400

Vendim i KM nr.446, datë 27.4.2009	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.475, datë 13.7.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e Presidentit, të Kuvendit dhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve”, të ndryshuar.....	3401
Vendim i KM nr.447, datë 27.4.2009	Për disa ndryshime në vendimin nr. 317, datë 30.5.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve të shtëpisë së pushimit, të Ministrisë së Brendshme, Durrës”, të ndryshuar.....	3403
Vendim i KM nr.448, datë 27.4.2009	Për një ndryshim në vendimin nr.455, datë 18.7.2007 “Për pagat dhe shtesat mbi pagë të punonjësve të shërbimit pyjor”, të ndryshuar.....	3405
Vendim i KM nr.522, datë 13.5.2009	Për përcaktimin e pagës minimale, në shkallë vendi.....	3406
Urdhër i MB nr.350, datë 28.5.2009	Për aplikimin e shtetasve shqiptarë të cilët disponojnë pasaportë për jashtë shtetit për pajisje me letërnjoftim elektronik	3407

VENDIM
Nr.439, datë 22.4.2009

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.1694, DATË 24.12.2008 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE, PËR VITIN 2009, NË
MINISTRITË DHE INSTITUCIONET QENDRORE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10, të ligjit nr.10 025, datë 27.11.2008 “Për buxhetin e vitit 2009”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Pika 1 e vendimit nr.1694, datë 24.12.2008 të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1.Numri i punonjësve buxhetorë, për vitin 2009, në ministrinë dhe institucionet qendrore, është 89 796 veta, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”.

2.Ngarkohen ministrinë dhe institucionet qendrore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare. Përgjashtimisht, për punonjësit e arsimit parauniversitar, ky vendim i shtrin efektet nga data 1 janar 2009.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

Gr.	Ministrinë/Institucionet	Viti 2009
3	Kryeministria	128
4	Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës nga e cila:	774
	-Drejtoria e Standardeve	18
	-Shërbimi gjeologjik shqiptar	135
	-Dr.Metereologjisë e Kalibrimit	110
	-Qendra Kombëtare e Licencimit	35
5	Ministria e Bujqësisë, Ushqimit nga e cila:	2 198
	-Bordet e kullimit	650
	-Agjencia e pagesave	86
6	Ministria e Punëve Pub.Transportit dhe Telekomunikacionit	1360
10	Ministria e Financave nga e cila:	3168
	-Drejtoria e Përgjithshme e Doganave	1027
	-Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	1616
	-Drejtoria e Përgj.Parandalimit Pastrimit të Parave	26
	-Agjencia e Lojërave të Fatit	25
11	Ministria e Arsimit dhe Shkencës	39 231
	-Parauniversitar	38 322
12	Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve	1103
13	Ministria e Shëndetësisë	3530
14	Ministria e Drejtësisë nga e cila:	5027
	-Avokati i Shtetit	55
	-Zyra e Regjistrimit të Pasurive	550
	-Agjencia Komb.Kthim.Kompensim Prona	150
	-Shërbimi i provës	50
15	Ministria e Punëve të Jashtme	188
	Ambasadat dhe përfaqësitë	428
16	Ministria e Brendshme nga e cila:	13 255
	-Drejtoria e Rezervave të Shtetit	100

17	Ministria e Mbrojtjes	11791
18	Shërbimi Informativ Shtetëror	950
20	Dr.Përgjithshme e Arkivave	155
22	Akademia e Shkencave	31
25	Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta	1 434
26	Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Adm. të Ujërave	1 399
31	Agjencia Telegrafike Shqiptare	82
50	Instituti i Statistikës	169
57	Qendra Kombëtare e Kinematografisë	10
59	Inst.Rehabilitimit të të Përndjekurve Politikë	25
78	Ministria e Integritetit	77
82	Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit	6
87	Institucione të tjera qeveritare nga e cila:	103
	-Dr.e Sigurimit të Informac.të klasifikuar	38
	-Agjencia e Prokurimit Publik	36
	-Komiteti Shtetëror i Minoriteteve	9
	-Agjencia Komb.Shoqërisë së Informacionit	20
	Total numri i punonjësve	86 621
	Numri i punonjësve në institucionet e pavarura	3 175
	Total numri punonjësve buxhetorë	89 796

VENDIM
Nr.440, datë 27.4.2009

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 194, DATË 22.4.1999 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS SË PAGËS SË PUNONJËSVE
MËSIMORË, NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.10025, datë 27.11.2008 “Për buxhetin e vitit 2009”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.194, datë 22.4.1999 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

a) Lidhja nr.1 “Struktura e pagës për punonjësit mësimorë”, e përmendur në pikën 1, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

b) Lidhja nr.2 “Paga e grupit”, e përmendur në pikën 2, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

c) Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4. Punonjësit mësimorë efektivë që, për nevoja të procesit mësimor, japin orë mësimi mbi normën e lejuar mësimore, paguhen për çdo orë mësimore shtesë, në masën:

- Në shkollat e mesme 300 lekë;
- Në shkollat 9-vjeçare 250 lekë.

Punonjësit e jashtëm, të specialiteteve të ndryshme, që japin mësim në shkollat e mesme, në shkollat teknike e profesionale, si dhe në kurset e ndryshme (me përjashtim të kurseve, që ngrihen pranë shkollave të larta dhe institucioneve të tjera të kualifikimit të punonjësve mësimorë), për çdo orë mësimore shpërblehen në të njëjtën masë me punonjësit mësimorë efektivë, si më sipër. ”.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet buxhetore të vitit 2009, të parashikuara për rritjen e pagave.

3. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 maj 2009.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

STRUKTURA E PAGËS PËR PUNONJËSIT MËSIMORË TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

	Emërtimi	Paga mujore			
		Paga individuale			Shtesa e pozicionit
		Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikimin (SHK)	
		1	2	3	4
1	Drejtor i shkollës së mesme.Përgjegjës poligoni Drejtor i institutit të nxënësve që nuk shikojnë. Drejtor i institutit të nxënësve që nuk dëgjojnë. Drejtor në shkollat me probleme të larta mendore. Drejtor i konvikteve.	1	2% e P.G.	5% e P.G. 10% e P.G. 20% e P.G.	45000
2	Zëvendësdrejtor i shkollës së mesme. Përgjegjës i bazës prodhuese. Zëvendësdrejtor i institutit të nxënësve që nuk shikojnë. Zëvendësdrejtor i institutit të nxënësve që nuk dëgjojnë. Zëvendësdrejtor në shkollat me probleme të larta mendore. Drejtor i Qendrës Kulturore të Fëmijëve.	1	2% e P.G.	5% e P.G. 10% e P.G. 20% e P.G.	40000
3	Drejtor i shkollës 9-vjeçare	1	2% e P.G.	5% e P.G. 10% e P.G. 20% e P.G.	36000
4	Drejtor i shkollës fillore klasa I-IV Përgjegjës (kryemësues) i shkollës me klasë kolektive. Zëvendësdrejtor i shkollës 9-vjeçare. Përgjegjës sektori në Qendrën Kulturore të Fëmijëve.	1	2% e P.G.	5% e P.G. 10% e P.G. 20% e P.G.	34500
5	Drejtor i kopshtit me ushqim	1	2% e P.G.	5% e P.G. 10% e P.G. 20% e P.G.	33000
6	Drejtor i kopshtit pa ushqim	1			30000
7	Mësues në shkollat e mesme. Mësues në institutin e nxënësve që nuk shikojnë. Mësues në institutin e nxënësve që nuk dëgjojnë. Mësues në shkollat me probleme të larta mendore. Inspektor në Qendrën Kulturore të Fëmijëve	1	2% e P.G.	5% e P.G. 10% e P.G. 20% e P.G.	33000
8	Mësues në shkollat 9-vjeçare, klasa I-IX Edukator konvikti. Kujdestar konvikti.	1	2% e P.G.	5% e P.G. 10% e P.G. 20% e P.G.	30000

9	Eduaktor në kopësht fëmijësh	1	2% e P.G.	5% e P.G. 10% e P.G. 20% e P.G.	27500
10	Mësues	2	2% e P.G.	5% e P.G. 10% e P.G. 20% e P.G.	24500
11	Mësues	3	2% e P.G.	5% e P.G. 10% e P.G. 20% e P.G.	24500
12	Edukator në kopësht fëmijësh.	3	2% e P.G.	5% e P.G. 10% e P.G. 20% e P.G.	22 500
13	Edukator në kopësht fëmijësh.	2	2% e P.G.	5% e P.G. 10% e P.G. 20% e P.G.	22 500

Lidhja nr.2

VLERA E PAGËS SË GRUPIT SIPAS NIVELIT ARSIMOR

Grupi	Paga në lekë
1	12000
2	10000
3	8000
4	6000

VENDIM

Nr.441, datë 27.4.2009

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 561, DATË 16.8.2006 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PAGAT SIPAS GRADAVE PËR PUNONJËSIT, OFICERË DHE NËNOFICERË, TË GARDËS SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999, “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.10 025, datë 27.11.2008 “Për buxhetin e vitit 2009”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lidhja nr.1 “Niveli i pagës për gradë, sipas roleve, për punonjësit e Gardës së Republikës”, e përmendur në pikën 1 të vendimit nr.561, datë 16.8.2006 të Këshillit të Ministrave, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, do të përballohen nga fondet buxhetore të vitit 2009, parashikuar për rritjen e pagave.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrinë efektet financiare nga data 1 maj 2009.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

**NIVELI I PAGËS PËR GRADË SIPAS ROLEVE PËR PUNONJËSIT E GARDËS
SË REPUBLIKËS**

Roli i punonjësve sipas gradës	Grada	Paga bazë për gradë	
Për punonjësit oficerë	Madhor	Gjeneral garde	107 000
	I lartë	Kolonel	93 000
		N/kolonel	82 000
		Major	69 000
	I mesëm	Kapiten	58 000
		N/Kapiten	55 000
	I ulët	Toger	52 000
		N/toger	49 000
Për punonjës nënofficerë	Madhor	Kryekapter	41 000
	I lartë	Kapter	39 000
		Kapter shtabi	38 000
		Kapter mjeshtër	37 000
	I mesëm	Kapter i parë	36 500
		Kapter i dytë	36 000
		Kapter i tretë	35 500
	I ulët	Kapter i katërt	34 800
		Rreshter	33 600

VENDIM

Nr.442, datë 27.4.2009

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 901, DATË 19.12.2007 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË
NËPUNËSVE CIVILË/ NËPUNËSVE, NËPUNËSVE TË KABINETEVE DHE PUNONJËSVE
MBËSHTETËS NË ADMINISTRATËN E DISA INSTITUCIONEVE TË PAVARURA”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, nenit 18 të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, të nenit 5/1 të ligjit nr. 8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, të ligjit nr.9584, datë 17.7.2006 “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, dhe të ligjit nr.10025, datë 27.11.2008 “Për buxhetin e vitit 2009”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave:

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 901, datë 19.12.2007, të ndryshuar, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:
 - a) Lidhja nr. 1, që përmendet në pikën 2, të zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
 - b) Në pikën 3, vlera “11 000 lekë”, zëvendësohet me “12 000 (dymbëdhjetë mijë) lekë”.
 - c) Lidhja nr. 2, që përmendet në pikën 8, të zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
 - ç) Shkronja “c” e pikës 9, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“c. Paga e pozicionit “Sekretar i titullarit”, “Sekretar i organit kolegjal drejtues” është 53 000 (pesëdhjetë e tre mijë) lekë në muaj. Shtesa për vjetërsi në punë për pozicionin “Sekretar i

titullarit”, “Sekretar i organit kolegjal drejtues” jepet në masën 2 për qind pas çdo viti pune, deri në 25 vjet dhe llogaritet mbi vlerën 12 000 (dymbëdhjetë mijë) lekë.”.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e politikës së pagave, miratuar për vitin 2009.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 maj 2009.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

Klasa	Pozicioni	Kategoritë	Paga Mujore			
			Paga individuale			Shtesa e pozicionit
			1	2	3	4
			Paga e grupit (PG)lekë	Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV), në përqindje	Shtesa për kualifikim (SHK) lekë	Shtesa për pozicion (SHP) lekë
I	Sekretar i Përgjithshëm	I-b	12.000	2%		115.000
II	Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme	II-a	12.000	2%		105 000
	Drejtor drejtorie	II-b	12.000	2%		88 000
III	Përgjegjës sektori	III-a	12.000	2%		69 000
	Inspektor i auditimit të brendshëm.					
	Përgjegjës sektori	III-a/1	12.000	2%		60 000
IV	Specialist i nivelit të lartë	III-b	12.000	2%		52 000
	Inspektor i auditimit të brendshëm					
IV	Specialist i nivelit të mesëm	IV-a	12.000	2%		41 000
	Specialist	IV-b	12.000	2%		31 000

Lidhja nr.2

KATEGORIZIMI I POZICIONEVE TË PUNËS PËR FUNKSIONET E VEÇANTA NË INSTITUCIONET E PAVARURA

Institucioni	Pozicioni	Kategoria e pagës
Inspektorati i Lartë i Kontrollit dhe Deklarimit të Pasurive	Inspektor i lartë	II-a
	Ndihmës inspektorë të lartë	II-b
Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit	Përgjegjës i Studios së Monitorimit	III-a
	Monitorues	IV-a
Avokati i Prokurimeve	Inspektor	III-a
Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare	Inspektor në Drejtorinë e Inspektimit	III-a
Autoriteti i Konkurrencës	Inspektor i mbikëqyrjes së tregut Inspektor i hetimit	III-a

VENDIM
Nr.443, datë 27.4.2009

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 370, DATË 14.6.2006 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË
NËPUNËSVE TË ADMINISTRATËS SË PREFEKTIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar dhe të ligjit nr.10 025, datë 27.11.2008, “Për buxhetin e vitit 2009”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.370, datë 14.6.2006 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1.1. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Nivelet e pagave për funksionet e mëposhtme të jenë:

- | | |
|---|----------------|
| a) Prefekt i qarkut të Tiranës, | 115 000 lekë; |
| b) Prefekt i qarqeve të tjera, | 107 000 lekë; |
| c) Nënprefekt në nënprefekurat e Kavajës, Lushnjës dhe Sarandës, | 92 000 lekë; |
| ç) Nënprefekt në nënprefekurat e Krujës, Pogradecit, Librazhdit, Tepelenës, Përmetit, Matit, Pukës, Tropojës dhe Skraparit, | 85 000 lekë; |
| d) Nënprefekt në nënprefekurat e Malësisë së Madhe, Bulqizës, Peqinit, Gramshit, Devollit, Mallakastrës, Hasit, Kuçovës, Mirditës, Delvinës, Kurbinit dhe Kolonjës, | 79 500 lekë; |
| dh) Këshilltar i prefektit të Tiranës, | 62 000 lekë; |
| e) Zëdhënës i prefektit të Tiranës, | 52 000 lekë.”. |

1.2. Lidhja nr.1, që përmendet në pikën 2, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

1.3. Në pikën 3, vlera ”11 000 lekë” zëvendësohet me “12 000 (dymbëdhjetë mijë) lekë”.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e politikës së pagave, miratuar për vitin 2009.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrinë efektet financiare nga data 1 maj 2009.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Emërtimi	Kategoria	Paga mujore			
		Paga individuale			Shtesa e pozicionit
		1	2	3	4
		Paga e grupit (PG) lekë	Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV) përqindje	Shtesa për kualifikim (SHK) lekë	Shtesa për pozicion (SHP) lekë
Sekretar i Përgjithshëm në prefekturë	III-a	12 000	2%		69 000
Sekretar i Përgjithshëm në nënprefekturat Kavajë, Lushnjë dhe Sarandë	III-a/1	12 000	2%		60 000
Përgjegjës sektori në prefekturë	III-b	12 000	2%		52 000
	IV-a	12 000	2%		41 000
Përgjegjës zyre në prefekturë Përgjegjës zyre në nënprefekturë	IV-a	12 000	2%		41 000
Përgjegjës sektori në nënprefekturë Inspektorë auditit në refekturë	IV-a	12 000	2%		41 000
Specialist në prefekturë	IV-b	12 000	2%		31 000
	IV-c	12 000	2%		23 000
Specialist në nënprefekturë	IV-c	12 000	2%		23 000
Sekretar	IV-c	12 000	2%		23 000

VENDIM
Nr.444, datë 27.4.2009

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 881, DATË 20.12.2006 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR FUNKSIONET DREJTUESE
DHE PËR STRUKTURËN E NIVELET E PAGAVE NË MINISTRINË E PUNËVE
TË JASHTME”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 18 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, të nenit 45 të ligjit nr.9095, datë 3.7.2003 “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, dhe të ligjit nr.10 025, datë 27.11.2008 “Për buxhetin e vitit 2009”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lidhja nr.1, që përmendet në pikën 1 të vendimit nr.881, datë 20.12.2006 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e politikës së pagave, miratuar për vitin 2009.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 maj 2009.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

Pozicioni drejtues	Grada diplomatike	Paga mujore			Shtesa për gradë
		Paga individuale (paga bazë)			
	1	2	3	4	5
		Paga e grupit (PG) lekë	Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK) lekë	Shtesa për pozicion (SHP) lekë
Sekretar i Përgjithshëm	Ambasador	12 000	2%		115 000
Drejtor i Përgjithshëm	Ministër Fuqiplotë Ministër Këshilltar Konsull i Përgjithshëm	12 000	2%		105 000
Drejtor	Këshilltar	12 000	2%		88 000
Përgjegjës sektori	Sekretar i parë Konsull	12 000	2%		69 000
	Sekretar i dytë Zëvendëskonsull	12 000	2%		52 000
	Sekretar i tretë Agjent konsullor	12 000	2%		41 000
	Atashe	12 000	2%		31 000

VENDIM
Nr.445, datë 27.4.2009

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 500, DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELIT TË PAGAVE TË
PUNONJËSVE TË AVOKATIT TË POPULLIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, nenit 18 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.10 025, datë 27.11.2008 “Për buxhetin e vitit 2009”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.500, datë 18.7.2003, të ndryshuar, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:
 - a) Lidhja nr.1, që përmendet në pikën 1, të zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
 - b) Në pikën 2, vlera “11 000 lekë” bëhet me “12 000 (dymbëdhjetë mijë) lekë”.
 2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e politikës së pagave, të miratuar për vitin 2009.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 maj 2009.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

Klasa	Emërtimi	Paga mujore			
		Paga individuale (paga bazë)			Shtesa e pozicionit
		1	2	3	4
		Paga e grupit (PG)	Shtesa vjetore për vjetërsi (SHK)	Shtesa për kualifikim (SHP)	Shtesa për pozicion (SHP) lekë
I-a	Sekretar i Përgjithshëm	12 000	2%		126 000
II-a	Ndihmëskomisioner, kategoria e parë	12 000	2%		105 000
II-b	Ndihmëskomisioner, kategoria e dytë Drejtor drejtorie	12 000	2%		88 000
III-a	Përgjegjës sektori	12 000	2%		69 000
IV-b	Specialist	12 000	2%		31 000

VENDIM
Nr.446, datë 27.4.2009

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR. 475, DATË 13.7.2007 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË NËPUNËSVE CIVILË, ZËVENDËSMINISTRIT DHE NËPUNËSVE TË KABINETEVE, NË KRYEMINISTRI, APARATET E MINISTRIVE TË LINJËS, ADMINISTRATËN E PRESIDENTIT, TË KUVENDIT DHE KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 18 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.10 025, datë 27.11.2008 “Për buxhetin e vitit 2009”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.475, datë 13.7.2007, të ndryshuar, të bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

a) Titulli i vendimit ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e Presidentit, të Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në Prokurorinë e Përgjithshme dhe Gjykatën e Lartë”

b) Lidhja nr.1, që përmendet në pikën 1, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

c) Në pikën 2, vlera “11 000 lekë” bëhet me “12 000 (dymbëdhjetë mijë) lekë”.

ç) Pas pikës 6/1 shtohet pika 6/2, me këtë përmbajtje:

“6/2. Nëpunësit në pozicionet “Specialist (arkivi)”, në Kryeministri, dhe në aparatet e ministrive të linjës, përfitojnë shtesë për kushte të vështira e të dëmshme për shëndetin. Kjo shtesë është në masën dhe sipas rregullave e kriterëve të përcaktuara në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave, për pagat e punonjësve mbështetës.”

d) Lidhja nr.2, që përmendet në pikën 7, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

dh) Pika 9 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“9. Struktura dhe nivelet e pagave për zëvendësministrin dhe nëpunësit e kabineteve në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në Prokurorinë e Përgjithshme dhe Gjykatën e Lartë përcaktohen, si më poshtë vijon:

- Zëvendësministri 136 000 lekë;

- Drejtori i kabinetit të Kryeministrit, të prokurorit të Përgjithshëm dhe kryetarit të Gjykatës së Lartë barazohen në pagë me nëpunësin civil, të kategorisë I-a;

- Këshilltari i Kryeministrit, shefi i Protokollit të Kryeministrit dhe drejtori i kabinetit të zëvendëskryeministrit barazohen në pagë me zëvendësministrin;

- Këshilltari i prokurorit të Përgjithshëm, këshilltari i kryetarit të Gjykatës së Lartë, ndihmësi i Kryeministrit dhe këshilltari i zëvendëskryeministrit barazohen në pagë me nëpunësin civil të kategorisë I-b;

- Ndihmësi i zëvendëskryeministrit dhe drejtori i kabinetit të ministrit barazohen në pagë me nëpunësin civil të kategorisë II-a;

- Këshilltari i ministrit dhe zëdhënësi barazohen në pagë me nëpunësin civil të kategorisë II-b;

-Ndihmësit ligjorë pranë prokurorëve në Prokurorinë e Përgjithshme dhe ekspertët në Prokurorinë e Përgjithshme barazohen në pagë me nëpunësin civil të kategorisë III-a;

- Sekretari i Kryeministrit, Presidentit,
Kryetarit të Kuvendit, kryetarit të Gjykatës së Lartë,
prokurorit të Përgjithshëm, zëvendëskryeministrit,
nënkryetarit të Kuvendit

64 000 lekë;

- Sekretari i ministrit, sekretar,
sekretari i këshilltarit të Presidentit

53 000 lekë.

Shtesa për vjetërsi në punë, për pozicionet “Sekretar i Kryeministrit”, “Sekretar i Presidentit”, “Sekretar i Kryetarit të Kuvendit”, “Sekretar i zëvendëskryeministrit”, “Sekretar i nënkryetarit të Kuvendit”, “Sekretar i ministrit”, “Sekretar” dhe “Sekretar i këshilltarit të Presidentit” jepet në masën 2 për qind pas çdo viti pune, deri në 25 vjet dhe llogaritet mbi vlerën 12 000 (dymbëdhjetë mijë) lekë.

Këto nivele pagash zbatohen edhe për funksionet ekuivalente të administratës së Presidentit, të Kuvendit dhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.”.

2. Pagat e punonjësve të tjerë të administratës së Prokurorisë së Përgjithshme dhe të Gjykatës së Lartë përcaktohen sipas vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave, për pagat e punonjësve mbështetës.

3. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e politikës së pagave, miratuar për vitin 2009.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 maj 2009.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

PAGA MUJORE					
Klasa	Kategoritë	Paga individuale (paga bazë)			Shtesa e pozicionit
	1	2	3	4	5
		Paga e grupit (PG) lekë	Shtesa vjetore për vjetësi (SHV) në përqindje	Shtesa për kualifikim (SHK) lekë	Shtesa për pozicion (SHP) lekë
I	I-a	12 000	2%		126 000
	I-b	12 000	2%		115 000
II	II-a	12 000	2%		105 000
	II-b	12 000	2%		88 000
III	III-a	12 000	2%		69 000
	III-a/1	12 000	2%		60 000
	III-b	12 000	2%		52 000
IV	IV-a	12 000	2%		41 000
	IV-b	12 000	2%		31 000

KLASIFIKIMI I VENDEVE TË PUNËS

Vendet e punës grupohen në 4 klasa, si më poshtë:

Klasa I: Ka përgjegjësinë për menaxhimin e institucionit, përcaktimin e strategjisë dhe hartimin e politikave të përgjithshme, në fushat që mbulon institucioni, koordinimin e këtyre politikave të përgjithshme dhe përdorimin eficient të të gjitha burimeve financiare, njerëzore etj. për arritjen e rezultateve të përcaktuara, si dhe dhënien e këshillimit përfundimtar dhe të drejtpërdrejtë ministrit ose drejtuesit të institucionit.

Në këtë klasë bëjnë pjesë kategoritë:

I-a Sekretar i Përgjithshëm në Kryeministri, Presidencë, Kuvend, Prokurori të Përgjithshme

Kancelar i Gjykatës së Lartë

I-b Sekretar i Përgjithshëm në ministri

Drejtor Departamenti në Këshillin e Ministrave

Drejtor i Departamentit të Administratës Publike

Klasa II: Është niveli më i lartë i manaxhimit të një institucioni dhe ka përgjegjësi për hartimin e politikave në një fushë të caktuar dhe për arritjen e rezultateve të përcaktuara në këtë fushë.

Në këtë klasë bëjnë pjesë kategoritë:

II-a Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme

II-b Drejtor Drejtorie

Klasa III: Bën të mundur koordinimin e mendimit dhe opsioneve të reja politike për një fushë të caktuar të specialitetit, zbatimin e politikave në këtë nivel, përgatitjen e propozimeve përfundimtare të cilat duhen aprovuar nga niveli menaxhues më i lartë. Kjo klasë bën të mundur gjithashtu edhe zgjidhjen e problemeve komplekse që lidhen me menaxhimin e projekteve të mëdha ose sektorëve/njësive brenda institucionit.

Në këtë klasë bëjnë pjesë kategoritë:

III-a Përgjegjës sektori

III-a/1 Përgjegjës sektori

III-b Specialist i nivelit të lartë

Klasa IV: Kjo klasë merret me zbatimin e politikave ekzistuese, koordinimin e aktiviteteve të stafit mbështetës, si dhe me formulimin dhe vlerësimin e opsioneve politike mbi një fushë të caktuar, duke u bazuar në eksperiencën profesionale të fushës, njohuritë e specialitetit, analizën e informacionit dhe kërkimin.

Në këtë klasë bëjnë pjesë kategoritë:

IV-a Specialist i nivelit të mesëm

IV-b Specialist

VENDIM

Nr.447, datë 27.4.2009

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.317, DATË 30.5.2007 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË PUNONJËSVE TË SHTËPISË SË PUSHIMIT, TË MINISTRISË SË BRENDSHME, DURREË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.10 025, datë 27.11.2008 “Për buxhetin e vitit 2009”, me propozimin e Ministrisë të Brendshme dhe të Ministrisë të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.317, datë 30.5.2007, të ndryshuar, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:
 - a) Lidhja nr.1, që përmendet në pikën 1, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
 - b) Në pikën 2, vlera “11 000 lekë” bëhet “12 000 (dymbëdhjetë mijë) lekë”.
 - c) Lidhja nr.2, që përmendet në pikën 6, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
 2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e planifikuara për politikatat e rritjes së pagave, miratuar për vitin 2009.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 maj 2009.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE PËR POZICIONET “SPECIALIST”, “PËRGJEGJËS SEKTORI” DHE “DREJTOR” NË SHTËPINË E PUSHIMIT TË MINISTRISË SË BRENDSHME, DURRËS

Emërtimi	Kategoritë	PAGA MUJORE			Shtesa e pozicionit
		Paga individuale (paga bazë)			
		1	2	3	4
		Paga e grupit (PG) lekë	Shtesa vjetore për vjetësi (SHV) në përqindje	Shtesa për kualifikim (SHK) lekë	Shtesa për pozicion (SHP) lekë
Drejtor	III-a	12 000	2 %		69 000
Përgjegjës sektori	IV-a	12 000	2 %		41 000
Specialist	IV-b	12 000	2 %		31 000

Lidhja nr.2

Nr.	Pozicioni	Paga bazë mujore	Shtesë për kushte pune (lekë/muaj)
1.	Përgjegjës (shërbimi i ushqimit dhe restorantit)	40 500	5 000
2.	Përgjegjës (gjelbërimi, aktivite të tjera ndihmëse)	33 500	
3.	Kuzhinier	29 000	5 000
4.	Banakier	29 000	
5.	Administrues hoteli	29 000	5 000
6.	Ndihmëskuzhinier	26 500	3 000
7.	Llogaritar Kamarier Receptionist Mekanik	23 500	

	Shofer i titullarit Magaznier		
8.	Elektriçist Hidraulik	20 500	3 000
9.	Marangoz Bojaxhi	20 500	2 000
10.	Punëtor (hoteli) Punëtor (gjelberimi)	19 600	
11.	Punëtor (kuzhine) Punëtor (restoranti)	19 000	
12.	Punëtor (lavanteri)	18 000	

VENDIM
Nr.448, datë 27.4.2009

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.455, DATË 18.7.2007 “PËR PAGAT DHE SHITESAT MBI PAGË TË PUNONJËSVE TË SHËRBIMIT PYJOR”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 4 të nenit 7 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", të ndryshuar, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 10 025, datë 27.11.2008 “Për buxhetin e vitit 2009”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lidhja nr.1 “struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e shërbimit pyjor”, që përmendet në pikën 1 të vendimit nr.455, datë 18.7.2007 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e parashikuara për rritjen e pagave, miratuar për vitin 2009.

3. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 maj 2009.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E SHËRBIMIT PYJOR

Nr.	Klasa	Paga bazë mujore në lekë
1.	I	18 000
2.	II	18 300
3.	III	18 600
4.	IV	18 900
5.	V	19 200
6.	VI	19 500

7.	VII	20 500
8.	VIII	21 500
9.	IX	22 000
10.	X	23 000
11.	XI	24 000
12.	XII	24 500
13.	XIII	25 000
14.	XIV	26 000
15.	XV	28 000
16.	XVI	29 000
17.	XVII	30 500
18.	XVIII	31 500
19.	XIX	32 000
20.	XX	33 000
21.	XXI	35 000
22.	XXII	36 000
	XXIII	38 000

VENDIM

Nr.522, datë 13.5.2009

PËR PËRCAKTIMIN E PAGËS MINIMALE, NË SHKALLË VENDI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 111 të ligjit nr.7961, datë 12.7.1996 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të neneve 2 e 5 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Paga bazë minimale mujore për punonjësit, në shkallë vendi, e detyrueshme për t’u zbatuar nga çdo person juridik a fizik, vendas ose i huaj, të jetë 18 000 (tetëmbëdhjetë mijë) lekë.
2. Paga bazë minimale mujore jepet për 174 (njëqind e shtatëdhjetë e katër) orë pune në muaj, të kryera gjatë kohës normale të punës.
3. Paga bazë minimale orare të jetë 103 (njëqind e tre) lekë.
4. Shtesat me karakter të përhershëm jepen mbi pagën bazë.
5. Vendimi nr.995, datë 2.7.2008 i Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e pagës minimale, në shkallë vendi”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 maj 2009.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

URDHËR
Nr.350, datë 28.5.2009

**PËR “APLIKIMIN E SHTETASVE SHQIPTARE TË CILËT DISPONOJNË PASAPORTË
PËR JASHTË SHTETIT PËR PAJISJE ME LETËRNJOFTIM ELEKTRONIK”**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe të ligjit nr.9972, datë 28.07.2008 “Për ratifikimin e “Kontratës koncesionare “Për prodhimin dhe shpërndarjen e kartave të identitetit dhe të pasaportave elektronike” ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe Grupimit të SAGEM Securite dhe Fondit Shqiptaro-Amerikan të Ndërmarrjeve””,

URDHËROJ:

1. Asnjë shtetas shqiptar i cili disponon pasaportë për jashtë shtetit, nuk do të lejohet të aplikojë për pajisje me letërnjoftim elektronik, mbas datës 30 maj 2009.
 2. Punonjësit e zyrave të gjendjes civile do të punojnë gjatë të shtatë ditëve të javës.
 3. Orari i punës për zyrat e gjendjes civile do të jetë nga ora 08.⁰⁰ deri 13.⁰⁰ dhe 17.⁰⁰ deri 21.⁰⁰, për të gjitha ditët e javës.
 4. Çdo veprim i cili bie në kundërshtim me zbatimin e këtij urdhri, do të konsiderohet kundërvajtje administrative dhe do të ndëshkohet sipas dispozitave ligjore.
 5. Ngarkohen me zbatimin dhe ndjekjen e këtij urdhri prefektët, njësitë e qeverisjes vendore dhe Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BRENDSHËM
Bujar Nishani

**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 258 472 (Kryeredaktori).
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2009 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.**

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI I PROCEDURËS CIVILE	240 lekë
KODI PENAL	226 lekë

Hyri në shtyp më 29.5.2009
Doli nga shtypi më 29.5.2009

Tirazhi: 3300 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2009

Çmimi 20 lekë